

Udhëzues për Aplikimin Online, në Maturën Shtetërore 2015, nga Portali Qeveritar

1. Krijimi i profilit në portalin qeveritar

- Nëse ju nuk keni një profil në portalin qeveritar veproni si më poshtë:

Hapni browser-in (Mozilla Firefox, Google Chrome, Internet Explorer) dhe klikoni

www.new.e-albania.al (përkohësisht).

Kujdes!!

Nëse maturanti/kandidati ka aplikuar në portalin WWW.e-albani.al nuk është e nevojshme të aplikojë përsëri, pasi ai e ka krijuar tashmë profilin e tij në portalin qeveritar. Ky maturant/kandidat aplikimin do ta vazhdojë dhe do ta përfundojë në shkollë, nën kujdesin e mbikqyrësit.



Fillimisht bëjmë regjistrimin në portal. Për këtë ju duhet të klikoni te shenja .

Më pas do plotësoni të dhënat siç kërkohen më poshtë:

Të dhënat e përdoruesit

Kodi i përdoruesit :

Vendosni numrin tuaj personal

Fjalëkalimi :

Vendosni Fjalëkalimin tuaj

Fjalëkalimi përsëri :

Vendosni fjalëkalimin përsëri

E-mail :

Vendosni një adresë të saktë e-mail

Nr. Celular :

Vendosni një numër të saktë

Pyetja e sigurisë :

Vendlindja e nënes

Përgjigje :

Të dhënat e përdoruesit

Emri :

Emri si në dokumentin tuaj të identitetit

Atesia :

Plotësoni saktë atësinë tuaj

Mbiemri :

Mbiemri si në dokumentin tuaj të identitetit

Datëlindja :

Plotësoni datëlindjen tuaj

Nr. Letërnjoftim :

Plotësoni nr. tuaj të letërnjoftimit

Pranoj kushtet

← Klikoni Pranoj kushtet



Mos harroni të plotësoni pyetjen e sigurisë dhe përgjigjen tuaj, në rast harrimi të fjalëkalimit

← Klikoni Regjistrohu

Sqarime për plotësimin e fushave të mësipërme:

- Kodi i përdoruesit (është numri personal që gjendet në kartën tuaj të identitetit, pasaportë apo çertifikatë, siç tregohet në figurë më sipër).
- Fjalëkalimi: (vendosni një fjalëkalim tuajin).
- Fjalëkalimi përsëri: (ripërsëritni fjalëkalimin e vendosur më sipër).
- E-mail (**Kujdes!!** Vendosni një e-mail të vlefshëm dhe të saktë pasi do ju duhet në procedurat e mëvonshme).
- Nr. Celular (vendosni saktë një numër celulari, që e keni me vete ose të një personi që e keni pranë, pasi në celular ju vjen një kod që duhet ta përdorni brenda 120 sekondave).
- Pyetja e sigurise dhe Pergjigja (Plotësojini këto dy fusha se në rast se harroni fjalëkalimin tuaj nëpërmjet tyre do të merni një fjalëkalim të ri).

Kujdes!! Të dhënat tuaja personale duhet të jenë të sakta siç janë në dokumentat tuaj të identitetit. Këto të dhëna janë:

- Emri, Atësia, Mbiemri, Datëlindja (dd/mm/vvvv) (**Kujdes!!**, duhen shkruar siç janë në dokumentin e identifikimit).
- Nr. Letërnjoftimit (është numri që ka dokumenti juaj i identitetit – është i ndryshëm nga numri personal).

Klikoni mbi katrorin **Pranoj kushtet** dhe më pas shtypni butonin **Regjistrohu**.

Një kod do t'iu vijë në numrin tuaj të celularit, që duhet ta vendosni në fushën përkatëse brenda 120 sekondave, si në figurën më poshtë:



Klikoni **Vazhdo**. Në këtë moment profili juaj është krijuar.

Në adresën tuaj të email-it do t'iu vijë konfirmimi që aplikimi juaj në portalin qeveritar u krye me sukses.

2. Logimi në portalin qeveritar (Kjo vlen si për përdoruesit e rinj që sapo krijuan profilin, dhe për ata ekzistues që e kanë tashmë një profil).

Klikoni te butoni **Hyr**  tek 

Klikoni te **Identifikimi i qytetareve**.

The screenshot shows the 'GOVERNMENT GATEWAY - Ofrues Federativ' login page. At the top left is the 'e albania' logo. At the top right, there is a language dropdown set to 'Albanian' and an 'OK' button. The main heading is 'Ju lutem zgjidhni menyren e identifikimit:'. Below this are three buttons: 'Identifikimi i punonjesve qeveritare(GOV)', 'Identifikimi me certifikate', and 'Identifikimi i qytetareve'. At the bottom, a message reads: 'Nese nuk keni nje perdorues dhe fjalekalim , ju duhet te regjistroheni ne portal **Regjistrohu**'.

Vendosni kredencialet tuaja (numrin personal dhe fjalekalimin tuaj) dhe më pas kliko tek **IDENTIFIKOHU**.


The screenshot shows the 'GOVERNMENT GATEWAY - Ofrues Identiteti' login page. At the top left is the 'e albania' logo. At the top right, there is a language dropdown set to 'Albanian' and an 'OK' button. The main heading is 'Ju lutem shkruani kredencialet tuaja te GG.'. Below this is a form titled 'Informacioni i llogarise'. It contains two input fields: 'Kodi i perdoruesit(Numri Personal):' with the placeholder text 'vendosni numrin personal - kodi juaj', and 'Fjalekalimi:' with a masked password field. Below the form is a large dark button labeled 'IDENTIFIKOHU'.

Do t'iu shfaqet pamja si në figurën më poshtë:



Klikoni te **Shërbimet**.

Do t'iu hapet lista e shërbimeve të ofruara nga portali qeveritar, më pas klikoni te ARSIM.




Do t'iu hapet pamja si më poshtë:



Te **Matura Shtetërore** klikoni butonin



Në dritaren që do t'iu shfaqet klikoni **përdor** për të bërë aplikimin tuaj A1 ose A1Z.



3. Formularët A1 / A1Z

Klikojmë tek Apliko duke zgjedhur formularin A1 ose A1Z (përzgjedhja në përputhje me udhëzimet e MAS).

Kujdes!!


Formularin A1 e zgjedhin të gjithë maturantët e këtij viti mësimor.

Formularin A1Z e zgjedhin të gjithë aplikantët e tjerë, qofshin ato të viteve të kaluara, qofshin të ardhur nga jashtë vendit.




3.1 Formulari A1

Do ngarkohen automatikisht të dhënat tuaja personale (Pikat nga 1-6)



FORMULARI A1



PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE
Plotësohet vetëm nga maturantët që përfundojnë shkollën e mesme

I. Të dhëna personale.

1. Nr Personal në letërnjoftimin ID:

2. Emri: Atësia: Mbiemri:

3. Datëlindja (dd/mm/vv):

4. Vendlindja e maturantit:

5. Gjinia: Maskull Femer

6. Adresa email: Celulari i kontaktit (*):

I. Të dhëna shkollërore.

7. Prefektura (*):

8. Qyteti / Fshati:

9. Emri i shkollës ku studion (*):

10. Indeksi i profilit:

11. Emërtimi i profilit:

12. Klasa III / IV: (A, B, C, D, E, F, G, H, I, J, K, L, M, N, O, P, Q, R, S, T): Viti: III IV V

13. Do të aplikoni për studime jashtë vendit: Po Jo

14. Gjuha e huaj e detyruar që do të jape provim: D3 (*):


I. Të dhëna lëndore.

15. Lëndët me zgjedhje: Shuma e krediteve:


Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin përkatës të lëndës bërthamë. Përfshirje bëjnë lëndët e detyruara (Letërsi e gjuhë shqipe dhe matematikë)

Do filloni me plotësimin e të dhënave shkollërore.

Në figurën e mëposhtme është treguar një shembull:



FORMULARI A1



PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE
Plotësohet vetëm nga maturantët që përfundojnë shkollën e mesme

I. Të dhëna shkollërore.

7. Prefektura (*):

8. Qyteti / Fshati:

9. Emri i shkollës ku studion (*):

10. Indeksi i profilit:

11. Emërtimi i profilit:

12. Klasa III / IV: (A, B, C, D, E, F, G, H, I, J, K, L, M, N, O, P, Q, R, S, T): Viti: III IV V

13. Do të aplikoni për studime jashtë vendit: Po Jo

14. Gjuha e huaj e detyruar që do të jape provim: D3 (*):

I. Të dhëna lëndore.

15. Lëndët me zgjedhje: Shuma e krediteve:

Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin përkatës të lëndës bërthamë. Përfshirje bëjnë lëndët e detyruara (Letërsi e gjuhë shqipe dhe matematikë)

- Te pika 7 Plotësoni Prefekturën tuaj (Zgjidhni nga Lista më sipër)


Në shembullin e marrë më sipër Tiranë

- Zgjidhni shkollën tuaj në Pikën 9, Automatiki do të plotësohet Pika 8 (Qyteti/Fshati)
- Pika 10 dhe 11 do plotësohet në shkollë nën kujdesin e mbikqyrësit (nuk keni të drejta t'i plotësoni tani)
- Zgjidhni Vitin (III,IV,V) dhe Klasën (A,B,C,...) te Pika 12
- Te Pika 13 zgjidhni Po ose Jo, në varësi të faktit nëse do të aplikoni ose jo për studime jashtë vendit.
- Te Pika 14 zgjidhni nga lista gjuhën e huaj të detyruar, që do të jepni provim
Në shembullin e marrë më sipër Anglisht D3

Më pas zgjidhni dy lëndët me zgjedhje nga lista. Përbri gjeni dhe shumën e krediteve përkatëse.

Kujdes!! Plotësimi të bëhet në përputhje me udhëzimet e MAS.
Pasi të jeni siguruar klikoni butonin **Dërgo**.

Do merrni njoftimin: Paraqituni në shkollë të përfundoni aplikimin!



I njëjti mesazh do t'iu vijë në celular dhe adresën tuaj të e-mail.

Klikoni **Di** për të dalë nga portali qeveritar.





3.2 Formulari A1Z

Jemi në pamjen.



Zgjedhim Formulari A1Z dhe klik tek Apliko. Do të ngarkohen automatikisht të dhënat tuaja personale (Pika 1-6)

 **FORMULARI A1Z** 

PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE
Plotësohet vetëm nga ata që kanë kryer shkollën e mesme para vitit korrent.

I. Të dhëna personale.

1. Nr Personal në letërnjoftimin ID: [input field]

2. Emri: [input field] Atësia: [input field] Mbiemri: [input field]

3. Datëlindja (dd/mm/vv): [input field]

4. Vendlindja e maturantit: [input field]

5. Gjinia: Mashkull Femer

6. Adresa email: [input field] Celulari i kontaktit (*): [input field]

II. Të dhëna shkollore.

7. Prefektura (*): [dropdown menu: TIRANE]

8. Qyteti / Fshati: [input field: TIRANE]

9. Emri i shkollës ku studion (*): [dropdown menu: TIRANE - 399 - SINAN TAJFAJ]

9.1 Shkolla që keni përfunduar: E njëjtë Tjetër [input field: Eqrem Cabej]

10. Indeksi i profilit: [input field]

11. Emërtimi i profilit: [input field]

12. Do të aplikoni për studime jashtë vendit: Po Jo

III. Të dhëna lëndore.

13. ID e kandidatit: [input field]

14. Viti i përfundimit të shkollës së mesme: [dropdown menu: 2014]

15. Lëndët e detyruara:

15.1 Lëndët e detyruara që do të mbarten:

Lënda D1: [input field] Nota e shkallëzuar: [input field]

Lënda D2: [input field] Nota e shkallëzuar: [input field]

15.2 Lëndët e detyruara që do të japësh provim:

Lënda D1 [dropdown menu] Lënda D2 [dropdown menu]

16. Lëndët me zgjedhje:

16.1 Lëndët me zgjedhje që do të mbarten: Jo 1 2

Viti [dropdown menu: 2014] Lënda Z1 [input field] Nota e shkallëzuar: [input field]

Viti [dropdown menu: 2014] Lënda Z2 [input field]

Nota e shkallëzuar: [input field]

16.2 Zgjidh lëndët me zgjedhje që do të japësh provim:

[input field] Shuma e krediteve: [input field]

[input field]

Programi orientues i një lënde të thelluar përmban edhe programin përkatës të lëndës bërthamë.
Përfshirë bënë lëndët e detyruara (Letërsi e gjuhë shqipe dhe matematikë)

[Mbyll fomën] [Dergo]

Do të filloni me plotësimin e pjesës së dytë: **Të dhëna shkollore.**

- Te pika 7 Plotësoni Prefekturën tuaj (Zgjidhni nga Lista më sipër)

Në shembullin e marrë më sipër Tiranë

- Zgjidhni shkollën ku po bëni aplikimin në Pikën 9 (shkolla ku keni mbaruar, ose shkolla që ju është caktuar nga DAR/ZA), Automatikisht do të plotësohet Pika 8 (Qyteti/Fshati)

Në shembullin e marrë më sipër "Sinan Tafaj"

Në pikën 9.1 do klikoni **E njëjtë** nëse shkolla ku po bëni aplikimin është e njëjtë me shkollën ku keni ndjekur/përfunduar studimet.

Në pikën 9.1 do klikoni **Tjetër** dhe do të vendosni emrin e shkollës, nëse shkolla ku po bëni aplikimin nuk është e njëjtë me shkollën ku keni ndjekur/përfunduar studimet.

Në shembullin e marrë më sipër "Eqrem Çabej".


- Pika 10 dhe 11 do plotësohet në shkollë nën kujdesin e mbikqyrësit (nuk keni të drejta t'i plotësoni).
- Te Pika 12 shtypni Po ose Jo, në varësi të faktit nëse do të aplikoni ose jo, për studime jashtë vendit.

Pjesa e tretë **Të dhëna lëndore** do të plotësohen në shkollë në prani të mbikqyrësit në shkollën ku ju jeni përcaktuar për të aplikuar në përputhje me udhëzimet e miratuara nga MAS.

Kujdes!! Plotësimi të bëhet në përputhje me udhëzimet e MAS.

Pasi të jeni siguruar klikoni butonin **Dërgo**.

Do merrni njoftimin: Paraqituni në shkollë të përfundoni aplikimin!



I njëjti mesazh do t'iu vijë dhe në celularin dhe adresën tuaj të e-mail.

Klikoni **Di!** për të dalë nga portali qeveritar.



SUKSESE